



BASHKIA GJIROKASTËR

PROJEKT-BUXHET 2020

Buxheti 2020 ka krijuar një ndërveprim midis objektivave të bashkisë dhe komunitetit duke respektuar përdorimin e fondeve për një ndikim më të madh dhe kosto më të ulët. Buxheti në tërësi është në zbatim të legjislacionit në fuqi, konkretisht si më poshtë:

- a). Buxheti i vitit 2019.
- b). Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- c). Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- d). Ligji nr.9936 dt.26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.
- e) 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- f). Ligji nr 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar
- g). Udhëzimi nr 23, datë 30.07.2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njësitë e qeverisjes vendore”
- h). Udhëzimit nr 09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”
- i). Udhëzimeve plotësuese “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit ”.
- j.) Ligji nr 79/2017 “Për Sportin”

Ky projektbuxhet është hartuar si një ndërthurje ndërmjet prespektivës së zhvillimit të bashkisë sonë, të pasqyruar në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2020-2022 dhe nevojës aktuale për zgjerimin dhe rritjen e standarteve të shërbimeve që bashkia Gjirokastrë i ofron komunitetit të saj. Ai pasqyron mendimet, sugjerimet dhe problematikën e ardhura drejtëpërdrejtë nga grupet e interesit, nga specialistët e fushave të ndryshme si dhe vetë banorët në Njësitë Administrative dhe në qytet. Në këtë projekt buxhet pasqyrohen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet pavarësisht nga natyra e tyre dhe burimet e financimit. Projekt –buxheti 2020 është hartuar konform legjislacionit në fuqi, duke



BASHKIA GJIROKASTËR

respektuar parimin e një buxheti realist, gjithëpërfshirës, transparent dhe unik. Për të realizuar një buxhet sa më pranë realitetit bashkia i është referuar buxhetit paraardhës në lidhje me realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

➤ *MISIONI*

Bashkia Gjirokastrë funksionon në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” e cila siguron politika të efektshme, efikase në një nivel sa më afër qytetarve nëpërmjet shërbimeve dhe lehtësirave publike në përputhje me standartet e kërkuara me ligj, funksioneve dhe kompetencave të realizimit të detyrave nga agjencitë e vartësisë si dhe nxitjen e gjithëpërfshirjes të qytetarve.

➤ *OBJEKTIVAT STRATEGJIKE*

Për të përmbushur vizionin Bashkia Gjirokastrës nëpërmjet PPV të miratuar në Shtator 2017 ka zhvilluar 5 objektiva strategjike, të cilat do të udhëheqin zhvillimin në të gjithë territorin e Bashkisë për vitet në vijim. Këto objektiva paraqiten si më poshtë vijon:

Objektivi Strategjik 1: Forcimi i pozicionit kyç të Bashkisë, për tu bërë porta jugore e vendit dhe nyje për bashkëpunimin ndërkuftar. Duke forcuar në të njejtën kohë rolin e Gjirokastrës si një qendër e turizmit rajonal dhe portë drejt destinacioneve turistike të vendit.

Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja dhe promovimi i mjedisit kulturor të Bashkisë dhe të trashëgimisë kulturore (numër i madh vendesh me interes historik dhe kulturor, qyteti i vjetër i Gjirokastrës- monument UNESCO), me qëllim rivitalizimin turistik të rajonit.

Objektivi Strategjik 3: Rigjenerimi ekonomik i zonës, i udhëhequr nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, nëpërmjet zgjerimit të bazës prodhuese dhe të zhvillimit të balancuar të tre sektorëve të prodhimit. Përveç sektorit të turizmit, Bashkia e Gjirokastrës



BASHKIA GJIROKASTËR

siguron prodhime të rëndësishme bujqësore dhe aktivitet industrial, sektorë të cilët duhet gjithashtu të stimulohen. Prodhimi bujqësor është veçanërisht i rëndësishëm, duke marrë parasysh pozicionin e saj, përshkrimin e Bashkisë nga lumi Drino dhe tokat bujqësore afër tij kanë produktivitet të lartë. Në të njëjtën kohë ka edhe një sektor të fuqishëm industrial i cili është përqëndruar kryesisht përgjatë autostradës SH4.

Objektivi Strategjik 4: Mbrojtje dhe menaxhim i qëndrueshëm i mjedisit natyror, nëpërmjet evidentimit të elementëve të fortë të Bashkisë (zona e mbrojtur Kardiç, monumente natyrore, sipërfaqe pyjore) dhe mbrojtje si e sistemeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (burime, lumi Drino, liqeni Viroi), edhe të sistemit të tokës natyrore dhe bujqësore nga aktivitetet njerëzore.

Objektivi Strategjik 5: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve, nëpërmjet përmbushjes së infrastrukturës teknike dhe krijimit të një niveli të lartë të infrastrukturës sociale. Paralelisht duhet të jepen mundësi më të mira punësimi dhe të ketë një rigjallërim të qytetit të Gjirokastrës nëpërmjet rigjenerimit urban.

➤ **PROGRAMET**

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e veta dhe të deleguara. Këto të fundit duhet të shoqërohen me fonde të mjaftueshme nga qeverisja qendrore për të financuar kostot e ushtrimit, por që shpesh herë një pjesë e konsiderueshme e kostove mbulohe nga të ardhurat e bashkisë. Njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë funksione dhe kompetenca në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, e shërbimeve sociale, e kulturës, sportit, e shërbimeve argëtuese, e mbrojtjes së mjedisit, e bujqësisë, pyjeve, kullotave, natyrës dhe biodiversitetit, e zhvillimit ekonomik, dhe në fushën e sigurisë publike. Bashkia Gjirokastrë në përputhje me zbatimin e ligjit ushtron funksionin e vet nëpërmjet disa programeve të cilët paraqiten si më posht:



BASHKIA GJIROKASTËR

PLANIMIFIK, MENAXHIM, ADMINISTRIM (01110)
POLICIA BASHKIE (03140)
SHËRBIMI ZJARFFIKËS (03280)
UJITJA DHE KULLIMI (04240)
ADMINISTRIMI I PYJE KULLOTAVE (04260)
MIRËMBAJTJA E RRUGËVE RURALE (04520)
SHËRBIMET PUBLIKE (06260)
AKTIVITETET SPORTIVE (08140)
AKTIVITETET KULTURORE (08250)
ARSIMI PARASHKOLLOR (09120)
ARSIMI PARAUNIVERSITAR (09230)

PROGRAMET BUXHETORE 2020

QËLLIMI I PROGRAMIT

Në zbatim të funksioneve të përcaktuara në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Bashkia Gjirokastrë ushtron funksionet e veta nëpërmjet 12 programve buxhetore. Qëllimi i përcaktimit të programeve është rezultati i arritjeve të objektivave të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe orientimit të shërbimeve ndaj komunitetit nën kornizën e fondeve buxhetore. Shpërndarja e fondeve financiare në programe buxhetore përcakton prioritetin e Bashkisë për ofrimin e shërbimit publik në komunitet.

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Programi buxhetor është tërësia e objektivave strategjike, politikave, misionit, administrimit, menaxhimit dhe ushtrimit të funksioneve të përcaktuara në ligj të qeverisjes, këto të përkthyer në rezultate specifike të matura në kohë, sasi dhe kosto. Fondet financiare janë ato të cilat përcaktojnë orientimin e politikës së funksionit të ushtruar.

PRODUKTI I PROGRAMIT

Produkti I programit është tërësia e shërbimeve të siguruara nga kryerja e veprimtarisë financiare buxhetore. Veprimtaritë buxhetore janë të orientuara drejt objektivave të përcaktuara në programe. Produkti I programit përcakton nivelin e arritjes së

BUXHET 2020 DHE PBA 2020- 2022

Buxheti vjetor bën lidhjen e politikave dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor me prioritetet e Bashkisë nën tavanet buxhetore. Buxheti vjetor përbën vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm. Ligjit nr 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” përbën kornizën ligjore për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e buxhetit.

Udhëzimi nr 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njësitë e qeverisjes vendore” është udhërrëfyese i përgatitjes së programit afatmesëm, viti i parë i të cilit është buxheti vjetor mbi bazën e programeve buxhetore.



BASHKIA GJIROKASTËR

objektivit dhe përbën bazën e matjes së performancës të buxhetit si një instrument politik-bërës.

Përgatitja e dokumentit të buxhetit vjetor shkon përtej një planifikimi të thjeshtë të të ardhurave dhe shpenzimeve. Planifikimi buxhetor duhet të shkojë përtej kalkulimit mekanik të të ardhurave dhe shpenzimeve. Hapi i parë i planifikimit buxhetor duhet të jetë vlerësimi dhe parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqëruara me element cilësor që kanë të bëjnë me orientimin e zhvillimit të territorit të administruar nga pushteti lokal. Një planifikim buxhetor optimal do të konsiderohet përputhja e elementeve të zhvillimit strategjik me fondet buxhetore duke qenë se këto janë të kufizuara. Procesi i buxhetimit paraqet një hap thelbësor duke filluar si një cikël me planifikimin strategjik të politikave.

Referuar ligjit 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” buxheti është tërësia e të ardhurave të veta, transfertave nga pushteti qendror dhe shpenzimeve.

TËRËSIA E TË ARDHURAVE QË PËRBËJNË BURIMIN FIANANCIAR TË BUXHETIT

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës të pakushtëzuar nga pushteti qendror. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.



BASHKIA GJIROKASTËR

Bashkëpunimi i administratës së tatim taksave në bashki me komunitetin do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimit e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, me qëllim realizimin e objektivave madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të bashkisë.

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafuar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve.

Numri total i familjeve që parashikohet të përfshihet në skemën e detyrimeve fiskale është 8.598 familje. Për 1.406 familje janë parashikuar lehtësi fiskale për shkak të problemeve sociale. Bazuar në rregjistrin aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohen të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale është 1.401.

Biznesi i vogël zë 82% të numrit total, gjithashtu në detyrimet fiskale përfshihen edhe 39 institucione buxhetore. Peshën më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë bizneset, kjo për faktin se ka pak familje rezidente në territorin e bashkisë.

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2020 janë kryesisht: Taksa mbi ndërtesën që zë rreth 18.6 %, tarifa e ndriçimit që zë 13,7 %, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 4 %, tarifa për pastrimin që zë rreth 19 %, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 9 % etj. Këto 5 zëra kryesorë mbulojnë rreth 64 % të planit të të ardhurave të Bashkisë Gjirokastër.

➤ *Taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël.*

Në zbatim të ligjit 142/2015, cdo subjekt i cili realizon një qarkullim vjetor nga 5 milion lekë deri në 8 milion lekë i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat në masën 5 %. Mbledhjen e kësaj takse Bashkia Gjirokastër e administron nëpërmjet agjentit tatimor DRTGJ ku kjo e fundit mban 1% të shumës së derdhur.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore përfshijnë por pa u kufizuar në:



BASHKIA GJIROKASTËR

- të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve,
- të ardhurat nga pjesëmarrjet,
- të ardhurat nga interesat,
- të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

➤ **Taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohet cdo person fizik, juridik, vendas ose i huaj që zotëron një pasuri të paluajtshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë pavarësisht nga niveli i përdorimit. Në këtë taksë përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesat
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

➤ **Taksa mbi ndërtesën**

Baza e taksës mbi ndërtesën është sipërfqja e ndërtimit në metër katror për cdo kat mbi dhe nën nivelin e tokës. Dokumenti bazë për përcaktimin e sipërfaqes së ndërtesës është certifikata e pronësisë ose cdo dokument tjetër brenda ekstremiteteve administrative që vërteton pronësinë ose përdorimin e pasurisë. Në rastet kur nuk disponohet asnjë prej dokumentave të lartë përmendura atëherë bëhet vetëdeklarimi pranë Bashkisë. Taksës së ndërtesës i nënshtrohen:

- Personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
- Zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.



BASHKIA GJIROKASTËR

➤ ***Taksa mbi tokën bujqësore***

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektarë, në pronësi apo në përdorim të tatimpaguesit. Dokumenti bazë për përcaktimin e sipërfaqes së tokës është certifikata e pronësisë ose cdo document tjetër që vërteton përdorimin e saj. Në rastet kur nuk disponohet asnjë prej dokumentave të lartë përmendura atëherë bëhet vetëdeklarimi pranë Bashkisë. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

➤ ***Taksa mbi truallin***

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja në metër katror e tokës (jo bujqësore) brenda vijës kufizuese të ndërtesës e vërtetuar me dokumenta ligjor. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

➤ ***Taksa vendore në shërbimin hotelier***

Baza e kësaj takes është cdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës në bazë të numrit të netëve të qëndruara. Kjo taksë llogaritet mbi bazën e taksës së vendosur nga bashkia, të cilën e paguan klienti dhe mblidhet nga ofruesi i shërbimit për llogari të bashkisë. Parashikimi i taksës për periudhën afatgjatë është bërë në bazë të kapaciteteve dhe numrit të njëjësive duke përfutuar rritje në të ardhurën.



BASHKIA GJIROKASTËR

➤ ***Taksa e ndikimit në infrastrukturë***

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Për ndërtimet me qëllim banimi taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën nga 4% deri në 8% të çmimit të shitjes për metër katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas VKM “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

➤ ***Të ardhurat nga taksat e ndara***

Sipas përcaktimit të ligjit për procedurat tatimore dhe ligjeve të vecanta Bashkitë përfitojnë prej taksave të cilat ndahen nga pushteti qendror me atë vendor dhe konkretisht :

- ✓ 97% të të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluejtshme për individët, personat fizik dhe juridikë.
- ✓ 25% e të ardhurave nga taksa vjetore e qarkullimit të mjeteve të përdorura
- ✓ 5% e të ardhurave nga renta minerare.
- ✓ 2% e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

➤ ***Të ardhurat nga burimet e veta vendore***

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, dhe ligjeve të tjera të vecanta pushteti vendor ka autonomi të plotë të vendosi tarifa për një shërbim apo një të drejtë që u jepet komunitetit. Niveli i



BASHKIA GJIROKASTËR

tarifës orientohet që të mbulojë shërbimin e ofruar por që kjo gjë nuk arrihet si rezultat i shumë faktorve. Shërbimet publike duhen të jenë të matshme nëpërmjet instrumentave specifik të cilët sigurojnë transparencën, aksesueshmërinë, cilësinën, sasinën dhe koston.

- Tarifa për menaxhimin e mbetjeve
- Tarifa për ndricimin rrugor
- Tarifa për gjelbërimin
- Tarifat për shërbimet administrative
 - a) Tarifa për dhënie lishencash
 - b) Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit
 - c) Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura
 - d) Tarifat e parkimit për automjetet e lishencuara dhe vend parkimet publike
 - e) Tarifat për pyjet dhe kullotat
 - f) Tarifat për shërbimet shtesë nga zjarrfiksjat
 - g) Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave
 - h) Tarifat nga dokumentat për tender, ankand etj
 - i) Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj
 - j) Tarifa për furnizim me ujë dhe kanalizime
 - k) Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kanalizimeve
 - l) Tarifa të tjera

- ❖ Taksat vendore
- ❖ Të ardhurat nga taksat e ndara
- ❖ Të ardhurat nga tarifat vendore
- ❖ Të tjera

- ❖ Grant i pakushtëzuar
- ❖ Transfertë e kushtëzuar
- ❖ Transfert specifike
- ❖ Grant konkurues



Transfertat nga pushteti qendror përbëhen nga ajo e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar dhe specifike.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga qeverisja qendrore transferta të pakushtëzuara të cilat përdoret në autonomi të plotë dhe transferta të kushtëzuara të cilat përdoren në mënyrë të përcaktuar nga organi që jep transfertën. Ligji i ri nr 68 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” përcakton qartë rregullat, politikat, instrumentat dhe procedurat për menaxhimin e financave publike në pushtetin vendor. Në zbatim të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” transferta e pakushtëzuar në një vit buxhetor është jo më pak se 1% e produktit të brendshëm bruto. Granti i pakushtëzuar nuk mund të jetë më i vogël se shuma e grantit e shpërndarë një vit më parë. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar ndahet midis bashkive sipas formulës e cila konsiston por nuk kushtëzohet në a) popullsinë rezidente, b) dendësinë e popullsisë, c) numrin e nxënësve në arsimin parauniversitar. Në bazë të procedurës të përcaktuar në ligj për vitin 2020 Bashkia Gjirokastër ka përfituar grant të pakushtëzuar në shumën 210.664 mijë lekë.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi bashkitë përfitojnë transfertë të kushtëzuar për mbulimin e kostos së funksioneve të deleguar dhe për projekte të vecanta të konsideruara në interes vendor ku dhe kërkohet bashkëpunimi me pushtetin vendor. Transferta specifike financon funksione të reja të transferuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme të qëndrueshme financimi gjithashtu financon shërbime në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme ku dhe kërkohet bashkëpunimi i qeverisjes vendore.



BASHKIA GJIROKASTËR

Transferta specifike është shpërndarë si më poshtë:

Konviktet e arsimit parauniversitar, të cilat megjithëse kanë qënë pjesë e Bashkisë prej vitesh, në transfertën specifike të vitit 2020 janë akorduar fonde, në një vlerë prej 18.070 mijë lekë, ku përfshihen fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.

Arsimi parashkollor

Në transfertën specifike të vitit 2020 me një vlerë totale 98.673 mijë lekë , janë fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor.

Arsimin parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2020 me një vlerë totale 5.869 mijë lekë , janë fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit të arsimit parauniversitar.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë fondet për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin me një vlerë totale 28.584 mijë lekë. Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri funksionon me një ligj të vecant nr 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

Rrugët rurale

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë fondet për rrugët rurale të transferuara, në një vlerë totale 7.639 mijë lekë. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime.

Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë fondet për Shërbimin Pyjor me një vlerë totale 6.412 mijë lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë fondet për ujitjen dhe kullimin me një vlerë totale prej 9.230 mijë lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.



BASHKIA GJIROKASTËR

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga qeverisja qendrore transferta të pakushtëzuara të cilat përdoret në autonomi të plotë dhe transferta të kushtëzuara të cilat përdoren në mënyrë të përcaktuar nga organi që jep transfertën. Ligji i ri nr 68 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” përcakton qartë rregullat, politikat, instrumentat dhe procedurat për menaxhimin e financave publike në pushtetin vendor. Në zbatim të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” transferta e pakushtëzuar në një vit buxhetor është jo më pak se 1% e produktit të brendshëm bruto. Granti i pakushtëzuar nuk mund të jetë më i vogël se shuma e grantit e shpërndarë një vit më parë. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar ndahet midis bashkive sipas formulës e cila konsiston por nuk kushtëzohet në a) popullsinë rezidente, b) dendësinë e popullsisë, c) numrin e nxënësve në arsimin parauniversitar. Në bazë të procedurës të përcaktuar në ligj për vitin 2020 Bashkia Gjirokastrë ka përfituar grant të pakushtëzuar në shumën 210.664 mijë lekë, në krahasim me vitin 2019 kemi një rritje me rreth 4.892 mijë lekë.

Shpenzimet janë të klasifikuara në një njësi të vetme shpenzuese me natyrë ekonomike paga, sigurime, operative dhe investime. Klasifikimi funksional i shpenzimeve është i detajuar në 12 programe buxhetore.

Detajimi i shpenzimeve në buxhetin 2020 është realizuar konform legjislacionit në fuqi si dhe duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave. Shpenzimet operative në buxhetin 2020 janë hartuar në përputhje me objektivat strategjike të Bashkisë duke garantuar përdorim ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve buxhetore. Bashkia i ka dhënë përparësi shpërndarjes së burimeve buxhetore sipas destinacionit të taksave dhe tarifave që komuniteti paguan. Pavarësisht se kostua e shërbimeve të ofruara kundrejtë komunitetit është shumë herë më e lartë se tarifat dhe



BASHKIA GJIROKASTËR

taksat e mbledhura. Bashkia ka respektuar me përpikmëri procedurat e menaxhimit të burimeve financiare duke bërë një shpërndarje të drejtë të fondeve. Shpërndarja e burimeve financiare për shpenzimet operative është bërë referuar buxhetit paraardhës duke mbajtur në minimum kostot administrative. Nevojat për shpenzime operative janë shpërndarë sipas programeve si më poshtë vijon:

- ❖ Aparati i bashkisë funksionon me programin 01110 i cili mbulon shërbimet mbështetëse për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose këshillin. Siguron planifikimin e zhvillimit të njësisë, menaxhimin e financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera të njësisë dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun. Për vitin 2020 programi buxhetor 01110 do të menaxhojë në total 22% të buxhetit në klasifikimin ekonomik si më poshtë :

- ↗ Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- ↗ Shpenzimet operative 602-609
- ↗ Shpenzime kapitale 230+231

Në zbatim të legjislacionit fondi i vecant i pagave do të përdoret për shpërblimin e daljes në pension, ndihmës financiare në rastet e fatkeqësisë, shpërblimin në masën e pagës për lejen e pakonsumuar në rastin e shkëputjes së menjëhershme të punës apo për të përballuar shpërblimin e vjetërsisë në punë në rastin e ndërprejes së mardhënieve të punës parashikuar kjo e fundit në ligjin e kodit të punës në Republikën e Shqipërisë.

Në buxhetin 2020 është parashikuar fondi financiar prej 12.507.000 Lëkë për likuidimin e kreditorve si rezultat i proceseve gjyqësore të regjistruara pranë Bashkisë deri në fund vitin 2019. Gjithashtu si një kërkesë ligjore për menaxhimin e aseteve në bazë të inventarit të pronave të miratuara nga Ministria e Brendshme është parashikuar një fond prej 500.000 Lekë për aplikimet pranë ZRPP. Përcaktimi i fondit është bërë në bazë të një prioriteti të ngushtë, kjo për vetë faktin e kostos së lartë të aplikimit.



BASHKIA GJIROKASTËR

Përsa u përket shpenzimeve kapitale është parashikuar fond limit prej 10.000.000 Lëkë për studim projektme dhe PDV. Përcaktimi i fondit limit është bërë mbi bazën e kërkesave të komunitetit për zhvillimin e territorit në kuadrin e rritjes së biznesit ekzistues. Në zbatim të ligjit nr 79/2017 “Për Sportin neni 21, Bashkia Gjirokastrë transferon në formë granti shumë financiare 2.000.000 Lekë si mbështetje ndaj të rinjve të futbollit. Granti do të transferohet pranë shoqërisë aksionere “KF Luftëtari në formë granti të kushtëzuar 200.000 Lekë për 10 muaj. Granti i radhës do të xhirohet pas administrimit të dokumentacionit për destinacionin përfundimtar të tij.

Programi 03280 është një funksion i transferuar nga pushteti qendror dhe si i tillë funksionon me grant të kushtëzuar dhe me të ardhura nga Bashkia. Për vitin 2020 programi menaxhon 5% të buxhetit të përgjithshëm nëpërmjet klasifikimit buxhetor si më poshtë:

- ❖ Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- ❖ Shpenzimet operative 602

Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri është strukturë e specializuar e gadishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi jetës, pronës, mjedisit, pyjeve, kullotave, aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore e ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Administrimi i pyje-kullotave (programi 04260)

- ❖ Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- ❖ Shpenzimet operative 602

Programi buxhetor 04260 administron 2% të buxhetit të përgjithshëm, ku peshën specifike e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime.



BASHKIA GJIROKASTËR

Menaxhimi i kanaleve vaditëse (programi 04240)

- ❖ Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- ❖ Shpenzimet operative 602

Programi buxhetor 04240 administron 2% të buxhetit 2020 ku peshën specifike në shpenzimet operative e zë planifikimi për karburat. Është pikërisht klasifikimi ekonomik t i cili përkthehet në shërbim të komunitetit. Planifikimi i karburantit për vitin 2020 ka marrë parasysh mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse në të gjitha Njësitë Administrative por edhe për të përballuar emergjencat që mund të has Bashkia.

Bashkia Gjirokastër ofron shërbimin për mbrojtjen e tokës bujqësore nëpërmjet reduktimit të shtrirjes urbane, zhvillimit teknologjik të prodhimit bujqësor, menaxhimit të hapësirave mjedisore, rehabilitimin dhe sistemimin e kanaleve vaditëse.

Mirëmbajtja e rrugëve rurale (programi 04520)

- ❖ Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- ❖ Shpenzimet operative 602

Si një program me ndikim të drejtë përdrejtë në infrastrukturën rrugore në Njësitë Administrative programi 04520 administron 3% të buxhetit 2020. Ky buxhet është i klasifikuar ekonomikisht për paga 6.027.000 Lekë, për shpenzimet rrjedhëse 5.800.000 Lekë (këtu kemi të bëjmë me bazën e parë materiale për mirëmbajtjen e rrugëve rurale) dhe shpenzime kapitale 3.439.000 Lekë si vazhdim i projektit të zgjerimit të ndricimit publik në fshatra nga viti 2019.

Shërbimet Publike (programi 06260)

- ❖ Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- ❖ Shpenzimet operative 602



BASHKIA GJIROKASTËR

Nëpërmjet buxhetit 2020 programi 06260 do të kryej shërbime ndaj komunitetit për **mirëmbajtjen e ndriçimit rrugor në fondin limit 4.800.000 Lekë**. Fondi limit është përlogaritur në bazë të inventarit të ndriçimit rrugor të evidentuar për çdo zonë. Përveç mirëmbajtjes së thjeshtë të ndriçimit rrugor është parashikuar edhe fondi limit **2.500.000 Lekë për pajisjen e këtij të fundit me lampa led**. Përsa i përket këtij aktiviteti të ri të ndriçimit rrugor bashkia konsiston në përmirësimin e ndriçimit dhe efikasitetin energjitike. Referuar gjelbërimit të ambienteve publike për vitin 2020 është akorduar fond në shumën 2.000Lekë. Materialet e gjelbërimit do të përdoren për mbjelljen e luleve sezonale, akacie, ligurstër, trëndafila dhe farë bari në gjithë ambientet publike. Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore është prioritet i buxhetit 2020 pa lënë pa përmendur edhe shtimin e hapësirave të gjelbërta duke ndërtuar dy miniparqe të rinj. Ky program administron 26% të buxhetit 2020 ku 23 % të buxhetit të programit e bëjnë shpenzimet kapitale në vlerë absolute 39.617.000 Lekë.

Aktivitetet sportive (programi 08140)

- ❖ Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- ❖ Shpenzimet operative 602
- ❖ Shpenzimet kapitale 231

Programi buxhetor 08140 administron 2% të buxhetit të përgjithshëm. Buxheti 2020 parashikon fond limit 5.300.000Lekë për rehabilitimin e fushës së vjetër dhe 4.254.000 Lekë për shpenzimet e personelit.

Programi buxhetor 08250 do të administrojë 6% të buxhetit të përgjithshëm si më poshtë vijon:

- ❖ Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601



BASHKIA GJIROKASTËR

❖ Shpenzimet operative 602

Duke marrë parasysh misionin e programit vlerat buxhetore të cilat zënë një përqindje të konsiderueshme në buxhet janë për aktivitetet kulturore, promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e bazës materiale “libra” për bibliotekat publike etj. Buxheti 2020 akordon fond buxhetor në shumën 9.000 Lekë për aktivitet kulturore si më poshtë vijon:

Teatri “Zihni Sako” (vënia në skenë e veprave të reja)

- Dy vepra për fëmijë dhe të rinj, Mars – Nëntor 2020.
- Muaji Janar deri në Mars 2020. Një vepër klasike.
- Komedi ose dramë në Mars –Qershor 2020.
 - Teatri i poezisë “Autobiografia e popullit në vargje” Janar-Qershor 2020.
- Dramë, komedi, Prill -Tetor 2020, një vepër.
 - Një vepër skenike nga një regjisor (jashtëm ose i huaj) Shtator-Dhjetor.
 - Takimi teator i shkollave të mesme. (V.O. Ky organizimi i takimit teator do të bëhet në bashkëpunim me D.A.R- in shkollat e 9-vjecare dhe të mesme të qytetit dhe studion e të rinjve pranë teatrit, Mars – Qershor 2020).
 - Festivali i teatrove “Kadri Roshi” edicioni i tretë 18-25.10.2020.
- ✓ 14 Marsi DITA E VERËS 14 Mars 2020
- ✓ 112 Lufta e Mashkullorës 18 Mars 2020
- ✓ Tango on tour 2020 (si dhe bashkëpunime të tjera me artist, shoqata dhe institucione kulturore 19 Marj – 30 Shtator 2020.
- ✓ Atelieja filmike me emrin “Gjirokastër” Korrik 2020.
- ✓ Teatri “Shtëpia që na bashkon të gjithëve” (dita bot.tetarit) 27 Mars 2020.
- ✓ “Rit-Brum-Fest” Festival (pranimi I Gjirokastrës në UNESCO 13.14.15 Korrik 2020).
- ✓ Festivali I sazeve dhe muzikës popullore.



BASHKIA GJIROKASTËR

- ✓ “Divani Lunxhiot “ Qershor – Korrik 2020
- ✓ Në kuadër të futjes së Iso-Polifonisë në UNESCO 25 Nëntor 2020.
- ✓ “76-vjetori I çlirimit të qytetit 18 Shtatori”
- ✓ “28-29 Nëntori”, kushtuar festave të Nëntorit
- ✓ “4 Dhjetor Ngritja e Flamurit” (4 Dhjetor 1912)
- ✓ “Gëzuar Vitin e Ri dhe fishekzjarre ”, 27-28-29 Dhjetor 2020

Trashëgimi Turizem (Disa projekt-ide për turizëm-trashëgimi)

- Panairi i madhe i trashëgimisë në Tiranë Prill .
- Celja e sezonit turistik “Gjirokastra 2020 ”, Maj 2020.
- Logot e muzeumeve deri në celjen e sezonit
- Mini aktivitete në qendrat historike, Kulinari + folk. (Qershor-Shtator)
- Takim (ose konferencë) me bizneset, artizanët, agjensitë turistike që operojnë në Gjirokastrë, institucionet, Universitetin “Eqerem Cabej”, të gjithë aktorët dhe faktorët - Prill 2020.
- Bashkëbisedim me operatorë turistike që operojnë në vend e më gjerë.
- Trainim për guidat turistike që ofrohen në territorin e Bashkisë Gjirokastrë
- Sinjalistika e shtigjeve turistike, banesa, monumente, muze, etj.
- Projekt artistik “Shtegëtimi i bagëtive” Maj-Qershor 2020.
- Ditët e trashëgimisë europiane 27-28-29 Shtator.

Biblioteka “A.Meksi”

- Aktivitet për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeun. Janar.
- Ekspozitë me vepra të shkrimtarit tonë Ismail Kadare.
- Dita kombëtare e Gjuhës Amtare. Aktivitet me nxënësit e shkollave 9-vjeçare. 21 Shkurt.
- Aktivitet me mësuese, gra e antëare të bibliotekës. 7-8 Mars.



BASHKIA GJIROKASTËR

- “Dita Botërore e Librit” ekspozitë me libra të dhuruar nga autorë Gjirokastrit
(aktivitete për poezinë në bibliotekën e fëmijëve “Tahsim Gjokutaj” 2 Prill .

Sportet

- a- Kampionati i tretë i minifutbollit midis institucioneve.
- b- Kampionati i futbollit të qendrave administrative të Bashkisë.
- c- Kros masiv I nxenesve të shkollave 9-vjecare dhe të mesme të Bashkisë.
- d- “Maratona” me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të institucioneve.

programi 09120- Arsimi Parashkollor, Kopshtet dhe Cerdhet.

- Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- Shpenzimet operative 602

Programi 09120 është funksion i deleguar dhe si i tillë financohet nga pushteti qendror dhe ai lokal. Transferta specifike përbën 79% të buxhetit të akorduar për këtë funksion. Shpenzimet operative për trajtimin ushqimor dhe ngrohjen janë dy zërat buxhetor që zënë peshë specifike më të madhe të buxhetit total të këtij funksioni pas shpenzimeve të personelit. Përveç shpenzimeve rrjedhëse të akorduara për këtë funksion buxheti 2020 parashikon fond 5.400.000 Lekë për rikonstruksionin e godinave arsimore parashkollor.

programi 09230 - Arsimi Parauniversitar dhe Konviktet

- Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- Shpenzimet operative 602

Pjesën më të konsiderueshme të buxhetit 2020 në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdësit Social e zë fondi për paga dhe sigurime, fond ky i cili transferohet pranë bashkisë si grant i kushtëzuar, fondi për karburant i cili përdoret për sistemin e ngrohjes në infrastrukturën arsimore parashkollor dhe parauniversitar dhe fondi për trajtimin ushqimor. Trajtim Ushqimor është fond i cili përdoret për trajtim me ushqim të fëmijëve në kopshte, cerdhe dhe menca të konvikteve të arsimit profesional sipas



BASHKIA GJIROKASTËR

nevojave ditore të ardhura nga çdo institucion. Bashkia akordon fond për trajtimin ushqimor në kopshte dhe cerdhe dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve akordon fond për trajtimin ushqimor të arsimit profesional në bazë të numrit të bursave të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Bashkia Gjirokastrë krijon, administron dhe ushtron funksione dhe kompetenca në interes të komunitetit. Buxheti i vitit 2020 i ka dhënë prioritet shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, për personat me aftësi të kufizuar, për fëmijët e braktisur, të dhunuar të cdo pakice kombëtare etj. Duke marrë parasysh faktin se sistemi i ri me pikëzime të përzgjedhjes së familjeve për trajtim me ndihmë ekonomike, trajton vetëm 50 familje nga 250 të tilla aplikuese në buxhetin e vitit 2020 është planifikuar fondi prej 500 Lekësh për ndihmën ekonomike. Gjatë vitit 2019 Bashkia Gjirokastrë u bë pjesë e një projekti me bashkë financim nga pushteti qendror me program “Ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Gjirokastrë”. Projekti konsiston në ofrimin e shërbimit të qendrës së emergjencës 70 orëshe për të gjitha kategoritë e viktimave të dhunës në familje si një shërim i qëndrueshëm dhe afatgjatë. Gjithashtu është planifikuar fondi 150 Lekë për paketën e emergjencës. Kjo e fundit do të suportojë dhe trajtojë raste të vecanta si trajtimi i fëmijëve të braktisur apo të dhunuar, gra të dhunuara, viktimat e trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë. Në kuptimin e termit trajtim do të përfshihen:

- Punë në terren për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge, dhënia e paketave ushqimore dhe veshje për fëmijët e varfër dhe të kequshqyer, të neglizhuar nga prindërit.
- Menaxhimi i rasteve të fëmijëve që braktisin shkollën dhe të çdo rasti të identifikuar ose të referuar nga institucionet ose OJQ në Njësinë e Mbrojtje së Fëmijëve
- Shpenzime proceduriale për seancat gjyqësore si dhe dokumentacionin përkatës që nevojiten gjatë identifikimit si: akt-noterial, vërtetime, certifikata, asistencë dublikate të lindjes, vërtetime nga hipoteka etj. (procedurat e vendosjes së fëmijës në familje kujdestare)



REPublika e SHqipërisë

BASHKIA GJIROKASTËR

Implementimi i projektit me bashkëfinancim pushtetin qendror.

ZËRAT	Njësia	Sasia	Kosto	I - Shuma e kërkuar MSHMS-së	VITI	VITI	VITI	TOTAL
			për njësi (në LEK)		2020	2021	2022	(I+II+III)
					90%	60%	30%	
Burime Njerëzore								
Koordinatori	për/muaj	12	70400	1.520.640	760320	506880	253440	1520640
Specialist psikolog	për/muaj	12	54400	1.175.040	587520	391680	195840	1175040
Specialist ligjor	për/muaj	12	54400	1.175.040	587520	391680	195840	1175040
(2) kujdestar	për/muaj	12	66360	1.433.376	716688	477792	238896	1433376
Menaxher Finance	për/muaj	12	55400	1.196.640	598320	398880	199440	1196640
Sigurime Shoqerore dhe shendetimore	për/muaj	12	0	1.085.616	651370	325684	108562	1085616
Vlera e Pagave				7.586.352	5.057.568			7586352
Aktivite	aktivite							0
Mbështetje psikoemocionale dhe shërbim këshillimi me viktimat e dhunës (12 orë në ditë * 1400 lek ora *15 dite)	Për çdo 2/muaj	18	252000	2.721.600	1360800	907200	453600	2721600
Mbështetje psikoemocionale dhe shërbim këshillimi me viktimat e dhunës (12 orë në natë * 600 lek ora * 15 dite)	Për çdo 2/muaj	18	108000	1.166.400	583200	388800	194400	1166400
Këshillim ballë për ballë (65 takime në muaj * 1400 lek/takim)	Për çdo 3/muaj	12	91000	655200	327600	218400	109200	655200
Takime informuese (qera, materiale, kafe, vakte)	aktivitet	18	25000	0	0	0	0	0
Kite Ushqimore (3 vakte / 200 Lek vakti/ 30. 5 ditë)	Për/muaj	36	10500	378000		113400	37800	151200



Shpenzimet kapitale përfshijnë mirëmbajtjen, riparimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës ekzistuese dhe asaj të re. Infrastruktura që I nënshtrohet shpenzimit kapital është ndërtesa, rrëgët, parqet, rrejtet e ndricimit pulik, kanalizimet, vendgrumbullimet e mbetjeve urbane, sistemet e transportit etj.

Burimet e financimit të investimeve kapitale janë të ardhurat e veta, granti pakushtëzuar dhe grantet konkurruese. Përvec investimeve me burim financimi si më lartë Bashkia Gjirokastër është përfituese e 3 investimeve me burim financimi projektet IPA nga Bashkimi European si më poshtë:

“GREENPOINT-MOB”

Projekti GREEN POINT MOB sjell një mënyrë inovative të riciklimit në zonat e largëta ku nuk ka asnjë mundësi për të ricikluar dhe në të njëjtën kohë promovon riciklimin në shtëpi. Qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të zonave të largëta duke rritur 50% të riciklimit të mbeturinave në raport me gjendjen e mëparshme.

Për të arritur këtë qëllim, GREEN POINT MOB synon në trajnimin e duhur të qytetarëve dhe aktiviteteve informuese mbi këto njësi që do të stabilizohen (një njësi ricikluese për të gjitha burimet e ndryshme të mbetjeve) me qëllim riciklimin në praktikë duke filluar nga gjeneratat e reja si dhe target grupeve më të moshuara.

Fushëveprimi i projektit do të jetë komunikimi me qytetarët nëpërmjet aktiviteteve të dedikuara si seminare informimi, organizimi i ngjarjeve të ndërgjegjësimit dhe shpërndarja e rezultateve të projektit. Përpara aktiviteteve, materiali informativ do t'u drejtohet shkollave, zyrave dhe kompanive. Qëllimi është të ndajë udhëzuesin e riciklimit në gjithsej 1500 familje. Projekti do të bëjë një vlerësim nevojave për riciklim si dhe trajnimin e nevojshëm të njerëzve për të ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj riciklimit. Qëllimi është krijimi i planeve konkrete të riciklimit local, brenda kohëzgjatjes së



BASHKIA GJIROKASTËR

projektit për përmirësimin e rezultateve të riciklimit. Do të zhvillohet analiza e statusit aktual e riciklimit në aspektin e pajisjeve. Brenda këtij aksioni të gjitha të dhënat e mbledhura në hapin paraprak do të analizohen dhe peshohen. Gjithashtu projekti synon që të ofrojë pajisjet e nevojshme gjatë Vlerësimit të Nevojave. Gjatë hartimit të kërkesave teknike projekti do të pajisë komunitetin e Gjirokastrës me 200 kazanë. Trajnimet në praktikën e riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve si dhe vazhdueshmërisë së praktikës së re të implementuar, do të përfshijnë punëtorët e Agjencisë së Shërbimeve Publike në total 200 orë. Qëllimi është që të ketë informacion mbi përditësimin e procesit të riciklimit dhe monitorimin më të mirë të njësive ricikluese. Një raport vlerësimi do të zhvillohet nga projekti për të gjithë partnerët duke përfshirë përfitimet financiare dhe mjedisore të riciklimit në ato zona si një mjet i rëndësishëm për përfundimin e riciklimit në komunitetet lokale. Së fundi bashkia Gjirokastrë do të zhvillojë një studim mbi ndikimin mjedisor të veprimeve. Kontributi financiar i BE-së për këtë projekt llogaritet në 75.000 Euro për partnerin Bashkia Gjirokastrë.

“HERBINNO”

Bimët medicinale i përkasin pasurisë së çmuar të florës vendase në rajonin ndërkufitar të Greqisë-Shqipëri, të cilat deri më tani kanë qënë jo fort të shfrytëzuara. Shumëllojshmëria e klimës dhe gjeomorfologjisë së rajonit lejon zhvillimin e varieteteve të mëdha dhe të rralla të bimëve, të cilat madje mund të rriten lehtësisht nëse ka interes dhe një rrjet marketingu. Përdorimi tradicional, mjekësor i këtyre bimëve është i njohur në rajon dhe daton në kohët e lashta.

Sot, më shumë se kurrë, përdorimi i këtyre bimëve si përbërës në produktet shëndetësore dhe të ushqyerit ka qënë thelbësore për shkak të zhvendosjes së konsumatorëve modernë në produkte natyrore, bimore për mirëqenien. Projekti **HERBINNO**, synon të promovojë shfrytëzimin dhe menaxhimin e bimëve medicinale lokale në një mjedis modern të konsumatorit ndërkombëtar. Qëllimi i projektit është çertifikimi i përbërësve aktivë dhe



BASHKIA GJIROKASTËR

vetitë bioaktive të bimëve dhe përdorimi i propozuar komercial për të marrë iniciativa të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përparimin e përdorimit të kësaj pasurie vendase, natyrore. Ajo ka për qëllim ta avancojë këtë proces duke trajnuar prodhuesit / kultivuesit e rinj dhe pastaj duke i lidhur ato me kompanitë bimore me qëllim të promovojë kontraktimin e fermerëve dhe rritjes së aktivitetit ekonomik në këtë fushë. Për më tepër, projekti synon të nxjerrë në pah vlerën kulturore dhe tradicionale të bimëve medicinale për shfrytëzimin e tyre në industrinë turistike.

Objektivat e projektit përfshijnë promovimin dhe publicitetin e tij nëpërmjet konferencave, seminareve trajnimeve, Infodays, broshura dhe botime të tjera. Gjithashtu objektivi kryesor përbën edhe inventarizimi i plotë, identifikimi i bimëve medicinale ndërkufitare dhe identifikimi i përbërësve bio-aktivë të disa bimëve medicinale në zonën ndërkufitare. Më tej do të vijojë kultivimi pilot i disa cajrave me kërkesa të njohura blerëse. Krijimi i 3 qendrave informative dhe ekspozuese si një tërheqje turistike; Krijimi i një kopshti botanik si një tërheqje turistike. Kërkimi dhe vlerësimi i tregut për shfrytëzimin inovativ të bimëve të përzgjedhura si bioaktive, të dobishme për përdorim njerëzor. Studim për krijimin e një platforme të përbashkët dypalëshe ndërkufitare; Krijimi i bazës së të dhënave bimore dhe prodhuese ndërkufitare dhe veprime aktive për lidhjen e fermerëve / prodhuesve me industrinë bimore.

“PROSFORA”

Zona ndërkufitare është e pasur me burime unike kulturore me rëndësi fetare që mund të përdoren për zhvillimin e aktivitetit ekonomik turistik, i cili aktualisht është i dobët. Në të njëjtën kohë, turizmi fetar po rritet me shpejtësi dhe konsiderohet të jetë një prioritet kyç në industrinë e turizmit global.

Në këtë kontekst, objektivi i përgjithshëm i projektit është të zhvillojë / aplikojë një produkt inovativ të turizmit, i cili i referohet zhvillimit të rrugëve të turizmit alternativ të



BASHKIA GJIROKASTËR

pelegrinazhit, duke përfshirë 15 monumente fetare të zgjedhura në zonën ndërkufitare. Rezultatet kryesore të projektit janë:

- Zhvillimi i një studimi strategjik mbi zhvillimin e turizmit të pelegrinazhit në zonën ndërkufitare
- Dokumentimi, zgjerimi dhe promovimi i 15 monumenteve të zgjedhura
- Zhvillimi dhe aplikimi i një produkti të specializuar turistik, i përbërë nga rrugët alternative turistike të pelegrinazhit
- Zhvillimi dhe zbatimi i një rrjeti të Udhëtimeve të Turizmit të Pelegrinazhit duke siguruar informacion on line, duke bërë të mundur që rrugët alternative të vizitave të zgjidhen sipas preferencave të vizitorëve dhe promovimin e monumenteve të zgjedhura fetare, si dhe ushqimin, produktet dhe shërbimet lokale të ofruara në këtë zonë
- Zhvillimi dhe funksionimi i 3 Qendrave të Informacionit dhe Promovimit të Turizmit të Pelegrinazhit në Janinë, Gjirokastër dhe Korçë
- Zhvillimi i strategjisë dhe emërtimit të rrugëve të turizmit të pelegrinazhit, duke përfshirë ushqimet, produktet dhe shërbimet vendore dhe komunitetin e biznesit të përfshirë
- Aktivitetet e promovimit të projektit dhe shpërndarjes së fletushkave informative.

Përmbajtja dhe qasja e projektit janë inovative, meqenëse është parashikuar zhvillimi dhe promovimi i turizmit të pelegrinazhit së bashku me promovimin e kuzhinës lokale, produkteve dhe shërbimeve, ndërsa përdorimi i metodave dhe mjeteve të teknologjisë së fundit do të adoptohet, me qëllim përmirësimin e përvojës së vizitorëve.

Më tej metodologjia e implementimit të projektit adopton aspekte inovative si përfshirjen në kontekstin e tij të aktiviteteve konfirmuese të vlefshmërisë, qëndrueshmërisë, transferueshmërisë dhe zgjerimit të rezultateve të arritura.

Karakteri ndërkufitar i projektit është i dukshëm, pasi 15 monumentet fetare të sugjeruara ndodhen përgjatë zonës ndërkufitare dhe përbëjnë një grup koherent dhe të integruar të burimeve kulturore që nuk mund të ndahen midis dy vendeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

Projekti pritet të rezultojë në rritjen e konsiderueshme të vizitave turistike dhe qëndrimeve jo vetëm ditore në zonën ndërkufitare, rritjen e të ardhurave të turizmit, punësimin dhe investimet në sektorin e turizmit, si dhe për të kontribuar në rritjen e përgjithshme socio-ekonomike të zonën së ndërhyrjes.

Prioriteti i bashkisë është zhvillimi i infrastrukturës në tërësi si infrastruktura e shërbimeve publike, ajo rrugore, arsimore, bujqësore, kulturore dhe e turizmit. Zhvillimi i infrastrukturës në tërësi mbështet shpërndarjen e shërbimeve në komunitet dhe luan një rol kyç si një indikator nxitës për zhvillimin ekonomik. Për vitin 2020 prioritet e bashkisë në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës kanë angazhuar fondet në shumën 58.153 Lekë të evidentuara sipas tabelës si më poshtë. Në zbatim të udhëzimit nr 1, datë 1701.2019 “Për zbatimin e buxhetit 2019”, ligjit nr 37/2015, datë 09.04.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraantarësimit (IPA II)”, Vendimit të Komisionit European N0 C(2015) 5482, 30-07-2015 për miratimin e programit inetrreg IPA Greece-Albani 2014-2020, ligjit nr 137/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Eurpian për programin interreg IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2014-2020” Bashkia Gjirokastër akordon fondin 2.000.000 Lekë për detyrimet e tatimit mbi vlerën e shtuar si rezultat i implementimit të projekteve me financim të jashtëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

Plani i investimeve për vitin 2020

Programi	Kapitulli	Projektet	Fond limit	Financim për 2020
0 453 0	1	Rikonstruksioni i rrugicës "Kapo Baco" në lagjen Varrosh	6,653	3,353
0 813 0	1	"Rikonstruksioni i fushës së vjetër dhe pallatit të sportit"	5,000	5,000
0 813 0	1	Mbyqirje kolaudime "Rikonstruksion i fushës së vjetër dhe pallatit të sportit"	300	300
0 453 0	1	Studim projektim "Rikonstruksioni I rrugës "Zeman Haska" Loti I	738	738
0 453 0	1	Rikonstruksioni I rrugës "Zeman Haska" Loti I	15,000	13,000
0 453 0	1	Mbyqirje "Rikonstruksioni I rrugës "Zeman Haska" Loti I"	260	260
0 453 0	1	Kolaudim "Rikonstruksioni I rrugës "Zeman Haska" Loti I"	38	38
0 453 0	5	Studim projektim "Rikonstruksioni I rrugës pranë kabinës deri në Lgj Manalat pranë Govaçajve	317	317
0 453 0	5	Rikonstruksioni I rrugës pranë kabinës deri në Lgj Manalat pranë Govaçajve	8,000	8,000
0 453 0	5	Mbyqirje "Rikonstruksioni I rrugës pranë kabinës deri në Lgj Manalat pranë Govaçajve	160	160
0 453 0	5	Kolaudim "Rikonstruksioni I rrugës pranë kabinës deri në Lgj Manalat pranë Govaçajve	24	24
0 626 0	1	"Ndërtimi I një parku publik në lagjen Zinxhira"	4,681	4,681
0 626 0	1	"Ndërtimi I një parku publik në lagjen 11 Janari"	3,231	3,231
0 626 0	1	Mbyqirje kolaudime "Ndërtimi I një parku publik në lagjen 11 Janari dhe lagjen Zinxhira"	500	500
0 111 0	5	Studime projektive	10,000	10,000
0 912 0	5	Rikonstruksion i institucioneve arsimore	5,000	5,000
0 912 0	5	Mbyqirje kolaudime "Rikonstruksion I institucioneve arsimore"	300	300
0 626 0	1	Rehabilitimi i driçimit publik në lagj "Zinxhira"	1,815	1,815
0 626 0	1	Mbyqirje kolaudime "Rehabilitimi i driçimit publik në lagj "Zinxhira"	200	200



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

0 111 0	2	TVSH për projektet me financim të jashtëm	2,000	2,000
		Shuma	60,202	58,917

Hartimi dhe prezantimi i buxhetit 2020 është i orientuar drejt produktit për rritjen e cilësisë së shërbimeve, zhvillimin ekonomik-social në komunitet. Planifikimi i buxhetit është bërë mbi bazën e përcaktimit të politikave të programeve dhe objektivave specifike të matshëm, përmes treguesve sasior dhe cilësor, të lexueshëm dhe të monitorueshëm lehtësisht në çdo kohë. Për të siguruar implementimin dhe arritjen e objektivave strategjike dhe zhvillimore buxheti 2020 lidhet me kontekstin afatmesëm për vitin 2020-2022.

K R Y E T A R

Flamur Golemi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR